

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje Matësa uji dhe kasetash”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34100000-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 8,650,000 (Tetë milion e gjashtë qind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKK sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

#### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Është kërkuar vlera maksimale prej 40% e fondit limit pasi është vlerë lehtësisht e përballueshme nga OE .

## **2.3 Kapaciteti teknike:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

## 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

**2.4.1** Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatë të vlefshme: EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. ***Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të garantohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës zbatojnë standarde të njohura ndërkombëtare për menaxhimin e cilësisë, duke siguruar besueshmëri në furnizimin e mallrave objekt prokurimi. Certifikimi ISO 9001 dëshmon se operatori ekonomik disponon procese të strukturuar për menaxhimin e cilësisë, kontrollin e proceseve dhe përmirësimin e vazhdueshëm. Ky kriter është proporcional dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, duke mos krijuar pengesa të panevojshme për pjesëmarrjen. *ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.*

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku pasqyron plotësimin e specifikimeve teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe neni 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar,

Qëllimi i tij është të mundësojë verifikimin e përputhshmërisë së mallrave/mjeteve të ofertuara me specifikimet teknike të përcaktuara në DST, si dhe të sigurojë një bazë të qartë krahasimi ndërmjet ofertave. Nëpërmjet këtij dokumenti shmangen deklaratimet e paqarta ose të paplota dhe garantohej që operatori ekonomik merr përgjegjësi për përmbushjen e kërkesave teknike, duke rritur sigurinë për realizimin e suksesshëm të kontratës.

**2.4.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë Garancie 1 (një) vjeçare për këto pjesë të mjeteve: Motor ,kamio,diferencial dhe freksion në rast defektesh garanton kryerjen e këtyre shërbimeve gjate periudhës se garancisë,(përfshihen rastet kur vërtetohet se defekti është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit)

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë cilësinë dhe funksionalitetin e mallit të furnizuar. Periudha e garancisë 1-vjeçare konsiderohet minimale dhe e domosdoshme në raport me natyrën e mallit objekt prokurimi. Kjo deklaratë siguron Autoritetin Kontraktor se, në rast defektesh që nuk vijnë si pasojë e keqpërdorimit, operatori ekonomik do të marrë përsipër riparimin ose zëvendësimin e pjesëve përkatëse, duke garantuar vijueshmërinë e funksionimit dhe shmangien e kostove shtesë.

**2.4.4** Operatori ekonomik duhet të paraqes *katalagun teknik të mjetit (përfshirë foton e mjetit)*, objekt i këtij prokurimi që duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar për pjesët që i përkasin të dhënave teknike të mallit objekt prokurimi, i cili shërben për të mundësuar verifikimin e plotë dhe të qartë të të dhënave të tij, për të garantuar përmbushje e specifikimeve teknike dhe vlerësimin e tyre.

**Argumentim:** Në zbatim të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ky kriter është vendosur me qëllim sigurimin e një vlerësimi sa më të saktë dhe objektiv të përputhshmërisë së mallit me specifikimet teknike të kërkuara. Paraqitja e katalogut teknik të mjetit, të shoqëruar me foto, i mundëson autoritetit kontraktor verifikimin e plotë dhe të qartë të karakteristikave teknike të mallit të ofertuar, si dhe krijon mundësinë për krahasim të drejtpërdrejtë dhe të barabartë midis ofertave të operatorëve ekonomikë, duke shmangur deklaratime të paqarta apo të paplota mbi parametrat teknikë. Kërkesa për përkthim në gjuhën shqipe dhe noterizim për pjesët që përmbajnë të dhëna teknike është e domosdoshme për të garantuar saktësinë dhe vlefshmërinë ligjore të informacionit të paraqitur, për të lehtësuar procesin e vlerësimit nga komisioni i prokurimit dhe për të siguruar transparencë dhe trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë. Ky kriter nuk konsiderohet kufizues, pasi katalogët teknikë janë dokumente standarde të disponueshme nga prodhuesit dhe lehtësisht të aksesueshme nga çdo operator ekonomik, duke e bërë kështu kërkesën proporcionale dhe të nevojshme për realizimin e një procedure të drejtë dhe të bazuar në përmbushjen e specifikimeve teknike.

**2.4.5** Deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjetit të targuar dhe regjistruar në pronësi të Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë

(zhdoganimin, regjistrimin, targimin me targa shqiptare, dhe logon e institucionit siguracion TPL).

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter vendoset për të garantuar që mjeti do të dorëzohet pranë Autoritetit Kontraktor i pajisur me të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor të nevojshëm për qarkullim, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përfshirja në çmim e proceseve si zhdoganimi, regjistrimi, targimi dhe siguracioni TPL siguron shmangien e kostove shtesë dhe vonesave për Autoritetin Kontraktor, duke garantuar që mjeti të jetë menjëherë i gatshëm për përdorim.

**Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

### **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë vendosur referuar materialit të hartuar nga grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Kamëz sh.a, ngritur me urdhërin nr.prot.412/1 datë 23/02/2026 në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur DST në SPE. Kriteret teknike të kualifikimit janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhërin nr. 412/9 datë 09/04/2026.

**Shenim:** Në cdo rast kur në specifikimet teknike dhe preventive mund të jetë përdorur si referencë emri i ndonjë marke apo emri të vecantë, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.

**Shënim:** Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo / dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

## **NJESIA E PROKURIMIT**